



PROGRAMI AVANCOJMË KOSOVËN SË BASHKU – ALTERNATIVA LOKALE THIRRJE PËR APLIKIM RFA-02-AKT-LS

Avancojmë Kosovën së Bashku - Alternativa Lokale (AKT - LS) është një projekt tre-vjeçar që synon rritjen e bashkëpunimit dhe ndërveprimit konstruktiv ndëretnik, kryesisht ndërmjet komunitetit shumicë shqiptar të Kosovës dhe komunitetit serb të Kosovës, e cila është jetike për sigurinë dhe stabilitetin e Ballkanit.

Programi bën thirrje për **Aplikime nga: Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme**¹

Përshkrimi i Projektit

Kjo kërkesë për aplikime për grant kërkon propozime nga ndërmarrjet ekzistuese e Vogla dhe të Mesme në 16 komunitet mbuluar nga projekti AKT-LS për aktivitetet që mund të mos jenë të kufizuara në:

- Krijimin e vendeve të punës, me fokus primar në punësimin e grave dhe të rinjve jo-shumicë;
- Aktivitetet që mbështesin aftësimin për punë të grave dhe të rinjve jo-shumicë;
- Krijimin e mundësive ekonomike për të rinjtë dhe gratë jo-shumicë;
- Zgjerimin e zhvillimit të bizneseve dhe qasje në mundësitë e financimit për bizneset e komunitetit jo-shumicë, ndërmarrësinë e të rinjve dhe ndërmarrjet në pronësi të femrave.

Informata mbi dhënien e grantit

Për çdo informatë mbi kontratën mund të kontaktoni z. Agron Selmani në 038 249 677/678 ose email (grants@kcdf.org).

Ju lutemi dorëzoni aplikacionin tuaj në zarf të mbyllur jo më vonë se më **10 prill, 2015 në 3:30 tek**: Agron Selmani, Menaxher për Grante, Zyra e Projektit Avancojmë Kosovën së Bashku, rr. Sejdi Kryeziu Nr. 16, Pejton, Prishtinë Alternativa Lokale, **apo tek**: Branislav Nesovic, Koordinator për Veri, AKTIV Office, Str. Cika Jovina Nr. 3, Mitrovica Veriore II/6. Çdo aplikacion i pranuar pas datës dhe kohës së caktuar për pranim do të konsiderohet si i vonuar dhe nuk do të kthehet përgjigje.

Takimet informative me aplikuesit potencial do të organizohen si vijon:

1. Asambleja Komunale në Pejë, adresa: 'Aleksandër Moisiu' p.n. Pejë më 16 mars, 2015 në ora 10:00
2. Zyra e AKTIV, adresa: Cika Jovina 3, Mitrovica veriore II/6, më 17 mars 2015 në ora 10:00
3. Asambleja Komunale Vushtrri më 17 mars 2015 në ora 14:00
4. Asambleja Komunale Graçanicë më 18 mars 2015 në ora 10:00
5. Shtëpia e Kulturës Kllokot më 18 mars 2015 në ora 14:00
6. Asambleja Komunale Shtërpçë më 19 mars 2015 në ora 10:00

Programi USAID/AKT – LS nuk do t'i mbulojë shpenzimet e pjesëmarrjes në takimet informative.

Është shumë me rëndësi që ta vizitoni faqen tonë www.kcdf.org/AKT-LS për dokumentin e plotë të Kërkesës për Aplikim dhe detajet e dorëzimit të Aplikacionit.

¹ Sipas ligjit Nr.03/L-031, një Ndërmarrje konsiderohet e Vogël nëse ka 10 deri 49 punëtorë dhe konsiderohet e Mesme nëse ka 50 deri 249 punëtorë.